Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0715

OSHP:2023/0719

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga;Isa Hasani-Kryetar, Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) RUNWAY SH.P.K., Sodex Group SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të POLICIA E KOSOVËS, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me uniforma për detyra taktike me numër të prokurimit 214-23-2841-1-1-1, me 05.01.2024, mori:

Vendim

1. Miratohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Runway" SH.P.K., nr. 2023/0715, e datës 21/09/2023, kundër "Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues" datës 29.08.2023, të AK – Policia e Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me uniforma për detyra taktike" me numër të prokurimit: 214-23-2841-1-1-1.

2. Miratohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Sodex Group"SH.P.K., nr. 2023/719, e datës 21/09/2023, kundër "Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues" datës 29.08.2023, të AK –Policia e Kosovës , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me uniforma për detyra taktike" me numër të prokurimit: 214-23-2841-1-1-1.

3.Mbetet në fuqi "Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues" datës 29.08.2023, të AK –Policia e Kosovës , për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr: 214-23-2841-1-1.

4. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore OE "Runway" SH.P.K., sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

5. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore OE –"Sodex Group".,sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 28.03.2023, Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me uniforma për detyra taktike" me numër të prokurimit: 214-23-2841-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 2,809,840.00 €.

Me 29.08.2023 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka anuluar aktivitetin e prokurimit për shkak se te gjitha ofertat e pranuara janë te pa përgjegjshme pasi nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara ne dosjen e tenderit, ne njoftimin për kontrate si dhe specifikacionet teknike.

Me 02.09.2023, OE "Sodex Group" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Me datë 04.09.2023 po ashtu edhe OE "Runway"SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 12.09.2023, Autoriteti Kontraktues ka publikuar një vendim përmes të cilit hedhen poshtë si te pa bazuara ankesat e te dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 21/09/2023, OEA "Sodex" SH.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 719/23 ndërsa me datë 21/09/2023 OE "Runway" ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 715/23.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 715/23 dhe ankesa nr. 719/23 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Përgjigjet dhe Pretendimet ankimore te ankesës me nr. 719/2023 të OE "Sodex" SH.P.K.

Pretendimi I pare (dhe kryesor) ankimore sipas ankesës 719/23 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE, ku sipas AK-së i njëjti nuk ka plotësuar kërkesën për 10K/10K, pasi sipas rezultatit te atestit del se xhaketa/materiali qëndrueshmërinë/rezistencën ndaj ujit e ka 10K/6K.

Sqarim : Shkornja “K” nga gjuha latine “Kilo” do thotë “mijë”, dhe çdo numër që pason me shkronjën “K” nënkupton atë numër plus tri zero (mijë) pas ati numri.

Në rastin konkret numri 10K duhet lexuar 10000 (dhjetëmijë).

Fillimisht sqarojmë se kërkesa e e AK-së 10K/10K nënkupton rezistencën ndaj depërtimit të ujit dhe aftësinë e frymëmarrjes së materialit, ku numri I parë 10K nënkupton 10000, dhe paraqet rezistencën e materialit ndaj depërtimit të ujit në milimetra te kolonës së ujit. Kjo nënkupton se materiali duhet ti qëndroj presionit prej 10 000 mm kolonë të ujit para se uji të filloj të depërtoj.

Ndërsa numri I dytë 10K paraqet aftësinë e materialit për liruar avullin, dhe numri 10000 nënkupton peshën në Gram të ujit në formë të avullit , e cila duhet të kaloj në një metër katror te bezit/materialit për 24 orë.

AK në rastin konkret gabimisht i është referuar atestit te ofruar nga OE, pasi pjesa që i referohet AK lidhur me 10K/6K, është pjesë e emërtimit të materialit që OE ka ofruar laboratorit për testim, do thotë 6K nuk është rezultat i testimit nga laboratori.Për më tepër ai material nuk shënon se do përdoret për xhaketën qe OE e ka ofruar për këtë aktivitet të prokurimit.Lidhur me atestin e xhaketës OE ka ofruar atest me nr.”SPC03D1593/2034” ku rezitenca ndaj depërtimit të ujit është bërë sipas standardit EN 343:2019.Megjithatë rezultatet e e këtij testimi, lidhur me rezistencën ndaj depërtimit të ujit e kanë me njësi matëse paskal dhe rezultati i testimit është “20700 pa” (pascal).Pas hulumtimeve të shumta që emi bërë, kemi gjetur se 20700pa (pasacal) janë ekuivalent me 2110mm kolumne të ujit.Ky rezultat na del nga gjithë kalkulatorët/konvertuesit qe kemi gjetur online.Bazuar në këto që cekëm më lart, vlerësojmë se OE nuk ka arritur të dëshmoj se xhjaketa e ofruar e ka rezistencën e ujit 10K (10000mm kolumne të ujit).Provë: Oferta e OE ankues – Atesti nr. SPC03D1593/2034, faqe 1, faqe 2 dhe faqe 3OE ankues pretendon se 10K është ekuivalent me 10000pa, mirëpo kjo konsiderojmë se nuk qëndron për arsyet e cekura si më lart. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Pretendimi nr.2.Pretendimi tjetër ankimorë ka të bëjë me arsyen e eliminimit nga AK, ku sipas AK-së OE nuk ka ofruar testime për qëndrueshmëri të ngjyrës ndaj klorit për pantallona, këmishë verore, dimërore etj.Megjithëkëtë AK me rastin shqyrtimit të kërkesës së OE, ka konstatuar se pretendimet për qëndrueshmëri ndaj klorit janë të bazuara, andaj nuk do të lëshohemi më tutje në këtë pikë.Mirëpo AK në refuzim të kërkesës për rishqyrtim lidhur me elasticitetin e këmishës me mëngë të shkurta pohon se OE ka ofruar ateste të ngjyrës në tërheqje.Ky konstatim i AK-së vlerësojmë se është i gabuar, pasi nuk ka atest te ngjyrës në tërheqje, dhe AK gabimisht rezultatin e qëndrueshmërisë së ngjyrës 4.5 ja përshkruan testit për elasticitet/tërheqjes i cili test realisht ka rezultatin 165.3lb dhe 124.6lb.Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore kundrejt OE Runëay, OE pretendon se përveq arsyeve të eliminimit nga AK, shton se OE Runëay po ashtu ka ofruar mostër me shirita të pa vullkanizuar. Si dëshmi OE ka ofruar foto nga msotrat e OE Runëay.Ne përveç fotos të ofruar nga OE, në cilësi të ekspertit kemi qenë për të shikuar mostrat pranë AK-së, dhe kemi gjetur se ashtu siç ka prezantuar OE ankues në foto, shiritat duket janë punuar në mënyrë jo kualitative, pasi shihet se përgjat shiritit ka hapësira/gjepa të ajrit.Megjithatë në ciëlsi të ekspertit (pavarësisht bindjeve që mund të kemi) nuk kemi dëshmi dhe nuk mund të japin përgjigje se a janë shiritat të vullkanizuar ose jo.

Përgjigjet dhe Pretendimet ankimore te ankesës me nr. 715/2023 të OE “Runway” SH.P.K.

Pretendimi I, pare ankimore sipas ankesës 715/23 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE, ku sipas AK-së i njëjti nuk ka plotësuar kërkesën për 10K/10K, pasi sipas rezultatit te atestit del se xhaketa/materiali qëndrueshmërinë/rezistencën ndaj ujit e ka 1300mm e jo 10000 (10K) siç është kërkuar.Sqarim : shkronja “K” nga gjuha latine “Kilo” do thotë “mijë”, dhe çdo numër që pason me shkronjën “K” nënkupton atë numër plus tri zero (mijë) pas ati numri.Në rastin konkret numri 10K duhet lexuar 10000

(dhjetëmijë).Fillimisht sqarojmë se kërkesa e e AK-së 10K/10K nënkupton rezistencën ndaj depërtimit të ujit dhe aftësinë e frymëmarrjes së materialit, ku numri I parë 10K nënkupton 10000, dhe paraqet rezistencën e materialit ndaj depërtimit të ujit në milimetra te kolonës së ujit. Kjo nënkupton se materiali duhet ti qëndroj presionit prej 10 000 mm kolonë të ujit para se uji të filloj të depërtoj.Ndërsa numri I dytë 10K paraqet aftësinë e materialit për liruar avullin, dhe numri 10000 nënkupton peshën në Gram të ujit në formë të avullit , e cila duhet të kaloj në një metër katror te bëzit/materialit për 24 orë.OE ka ofruar atest ku rezultati I qëndrueshmërisë/rezistencës së ujit është 1300 mm.Provë: Oferta e OE ankues – Raporti testimit nr.33200/10.05.2023OE ankues pretendon në ankesë se testi dëshmon se është ofruar rezistencë 1300K (që nënkupton 1300000), mirëpo kjo nuk qëndron.Në atestin e ofruar shumë qartë shihet se njësia matëse është "milimietra kolone uji", dhe rezultati është 1300+-10 (+-10 nënkupton devijimin/tolerancën e testit).Për më tepër, pas hulumtimeve të shumta që kemi bërë nuk kemi gjetur se ka material te rrobave me rezitencë 1300K (1300.000), pasi kjo do nënkuptonte rezistencë te materialit nën presionin e 1300 metrave kolonës së ujit.Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Pretendimi nr.2Arsyeja tjetër eliminimit është se mostra për xhaketë e OE ankues nuk e ka belin elastik.OE në ankesë parqet foton e mostrës, dhe e nënvizon pjesën elastike , mirëpo sipas nesh kjo është pjesa e epërme e shpinës/ më mes dy krahëve dhe nuk është pjesa e belit. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Pretendimi nr.3Arsyeja e eliminimit me radhë ka qenë se OE nuk ka ofruar testim për analizë të fibrave.Pas analizimit të ofertës së OE ankues, kemi gjetur se për xhaketë të jashtme dhe të brendshme ka ofruar teste ku figuron se materiali është 100% polyester.

Provë: Oferta e E ankues – Raporti testimit 33200/10.05.2023Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Pretendimi nr.4Arsyeja e eliminimit se pantallonat nuk e kanë pjesën e belit elastike.OE pretendon se plotëson kërkesën e AK-së.OE ofron fotografi të mostrës , mirëpo të njëjtën shihet se pjesa elastike është më poshtë, në nivel me gjepat e pantallonave, andaj konsiderojmë se nuk është në pajtim me kërkesat e dosjes.Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.Provë : Ankesa e OE ankues – Fotografia e mostrës.

Pretendimi nr.5Arsyeja e eliminimi është se OE nuk ka pjesën Velcro për vendosjen spaletave në Kraharor.OE pretendon se e plotëson kërkesën dhe në ankesë ofron foto të mostrës, mirëpo nga e njëjta foto shihet se Velcro për vendosjen e spaletave është pjesën e gjoksit, jo të kraharorit. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Pretendimi nr.6Arsyeja e eliminimit është se mostra e këmishës ka hapje në pjesën e epërme të shpinës, e cila nuk është parashikuar me dosje të tenderit.OE pretendon se mostra është në pajtim me kërkesa të dosjes, megjithëkëtë pas analizimit të dosjes dhe specifikave vlerësojmë se një gjë t tillë nuk ka qenë kërkese, dhe mostra nuk është në pajtim me kërkesa të dosjes.Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Pretendimi nr.7Arsyeja e eliminimit të OE ankues është se janë kërkuar 7 pulla për këmishën, ndërsa OE ankues ka ofruar mostrën me 6 pulla. Sqarojmë se kërkesa decidive në dosje ka qenë kështu: "Pulla te tipit 20 ligne (12.5mm)1 ne mes te pjesës së përparme të jakës,7 ne pjesën e përparme,2 pulla funksionale për secilën mëngë kur te palohet,2 pulla për rregullim te secilës mëngë,1 pulle rezervë, Pulla te tipit 14 ligne (8mm),2 pulla në pjesën e fshehur nën jakë;1 pulle rezervë"Nga fotot e mostrës të prezantuar nga OE ankues shihet këmisha ka 7 pulla duke përfshirë pullën e përparme të jakës.Në rastin konkret konsiderojmë se kërkesa e AK-së ka qenë sadopak konfuze, andaj bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është pjesërisht i bazuar dhe vlerësojmë se kjo mund të konsiderohet devijim i vogël në pajtim me dispozitat ligjore nw fuqi.

Pretendimi nr.8Arsyeja e eliminimit është se këmisha taktike me mëngë të shkurta është "E bërë materiali që nuk ngjitet me Velkro ose me sipërfaqe të tjera gërryese — sipas mostrës se dorëzuar Velkro ngjitet dhe fijet dalin materiali është i ndjeshëm".Në rastin konkret nuk mund të japim përgjigje pasi nuk kemi kapacitet Teknik / profesional për të bërë një testim të tillë, se a kapet materiali për "Velcro".

Pretendimi nr.9Arsyetimi i eliminimit se mungon testimi grisjes. Pas analizimit të ofertës së OE ankues kemi gjetur atestet ku është dhënë rezultati për girsjen.Provë : Atestet e ofruara nga OEBazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është I bazuar.

Pretendimi nr.10Arsyeja e eliminimit është se OE ka ofruar mostrën e kapelës e cila nuk është nga materiali "Rip stop".OE pretendon se mostra është në pajtim me kërkesë dhe i referohet atestimit për kapelën.

Pas analizimit të atestit për kapelën, vlerësojmë se në atest fjala "rip stop" është e shënuar te përshkrimi i mostrës që testohet, I cili përshkrim jepet nga vet klienti që e dërgon mostrën për testim. Ndërsa në rezultat e testimit nuk figuron se materiali është rip stop.

Për më tepër në cilësi të ekspertit shqyrtues, ne kemi qenë në vizitë pranë AK-Policia e Kosovës dhe kemi shikuar dhe analizuar mostrat, dhe vlerësojmë se mostra e kapelës së OE ankues nuk është nga materiali Rip Stop.

Sqarim shtesë: materialet rip stop janë materiale të cilat e kanë një qepje shtesë e cila e rritë rezistencën ndaj grisjes, zakonisht në formë katërkëndëshi ose gjashtëkëndëshi, dhe një qepje e tillë mungon mostrën e OE ankues.Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Pretendimi nr.11Arsyetimi tjetër për eliminim është se mungon atest/testimi I grisjes për kapelën.Pas analizimit të ofertës së OE ankues kemi gjetur se OE ka ofruar atest për kapelën ku gjendet edhe testimi i grisesjes.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Pretendimi nr.12-OE ankues pretendon se OE tjetër pjesëmarrës nuk ka ofruar xhaketën me tiketë ku shënon pesha e materialit. Po ashtu pretendon se pantallonat nuk e kanë përbërjen/materialin e kërkuar, se nuk kanë qëndrueshmërinë e larjes në temperaturë 40 gradë celsiusë siç është kërkuar.Pas analizimit të ofertës së OE tjetër pjesëmarrës kemi gjetur se i njëjti atestet i ka të deklaruara si informata konfidenciale, andaj të dhënat nga këto ateste nuk kemi drejtë ti bëjmë publike në këtë raport.Megjithatë japim përgjigje se për të gjitha këto kërkesa (që pretendon OE ankues) OE tjetër ofertues ka ofruar ateste në pajtim me kërkesat e dosjes duke përfshirë edhe temperaturën 40 gradë cilcius.Ndërsa sa i përket mostrave , pas vizitës që kemi bërë pranë AK-së dhe shikimit dhe analizimit të mostrave, vlerësojmë se të njëjtat janë në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit, përjashtimisht mostrës së kapelës e cila në pjesën e prapme e ka të shënuar "Kosovo Polcie", gjë që nuk është kërkuar me specifikacion teknik.Megjithëkëtë konsiderojmë se kjo përbën devijim të vogël, pasi mostra nuk ka mangësi nga ajo çka është kërkuar, mirëpo OE ka "shtuar" fjalët "Kosovo Police" me qëllim të identifikimit nga prapa. Kjo konsiderojmë se në rast të eventual të nënshkrimit të kontratë do ishte lehtësisht e evitueshme gjatë realizimit të kontratës.Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është pjesërisht i bazuar.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 21.09.2023 ka autorizuar eksperten shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 715/23 ndërsa me datë 22.09.2023 Paneli Shqyrtues ka autorizuar eksperten shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 719/23.

Lidhur me ankesën nr. 715/23 me datë 16.10.2023 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i AK."

Lidhur me ankesën nr. 719/23 me datë 16.10.2023 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK."

-Seanca shqyrtuese-

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e OE ankues;"SodexGroup&Runway" SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorëve ekonomik ankues janë pjesërisht te bazuara.

Paneli shqyrtues varën se LPP, ne nenin 4, paragrafi 1.36, ka definuar se nocionin për Tenderët e pa-përgjegjshëm – tenderi i cili nuk janë në përputhje me a) dosjen e tenderit, duke përfshirë kërkesat teknike dhe kontraktuale, b) kërkesat e legjislacionit relevant të Kosovës ose të cilët c) përndryshe nuk

përmbushin kërkesat e autoritetit kontraktues siç janë specifikuar në dosjen e tenderit.

Paneli shqyrtues vëren se Autoriteti kontraktues, Policia e Kosovës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me uniforma për detyra taktike" me numër të prokurimit: 214-23-2841-1-1-1, pas vlerësimit te ofertave tenderuese datës 29.08.2023, ka publikuar "Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues" për anulimin e aktiviteti te tenderimit për shkak se te gjitha ofertat tenderuese janë te papërgjegjshme, pasi nuk plotësojnë kërkesat e tenderit dhe specifikacionet teknike.

Paneli shqyrtues konstaton se Rregullorja 01/2022 Për Prokurim Publik në nenin 43.5 Procedura e prokurimit, ka përcaktuar se pas hapjes së ofertave tenderi duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm andaj dhe bazuar ne ket dispozite ligjore AK, ,ka anuluar procesin e prokurimit pas vlerësimit te ofertave si te papërgjegjshme.

Po ashtu Paneli shqyrtues konstaton se në këtë raste AK, Policia e Kosovës bazuar ne neni 54 te LPP-së "Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar", përmes letrës standarde për tenderuesin eliminuar i ka njoftuar që të dy operatoret ekonomik për shkaqet dhe arsyet vlerësimin e ofertës si administrativisht e papërgjegjshëm duke i paraqet dhe specifikuar të gjitha mangësitë e OE ne ofertën e tij tenderuese.

Paneli shqyrtues konstaton se ankesa është si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Runway" SH.P.K., dhe OE "Sodex Group"SH.P.K., kundër "Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues" datës 29.08.2023, të AK – Policia e Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me uniforma për detyra taktike" me numër të prokurimit: 214-23-2841-1-1-1. dhe mbetet në fuqi vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr: 214-23-2841-1-1, i AK, sipas nenit 43.5 të Rregullores 01/2022 Për Prokurim Publik.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimet ankimore të OE ankues janë të paqëndrueshme ashtu siç janë dhënë në konstatimin e panelit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 1 dhe 4 të LPP-së, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS, POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **RUNWAY SH.P.K., Sodex Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: